



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Duke u bazuar në vendimin e Kuvendit Komunal të Vitisë të datës: 30.07.2020 me numër të protokollit: 01-110/05-749 për shpalljen në diskutim publik projekt planin e punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2021 Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun në bashkëpunim me Sekretarinë e Kuvendit Komunal të Vitisë lëshon këtë:

NJOFTIM PUBLIK

LIDHUR ME DISKUTIMIN PUBLIK PËR PROJEKT PLANIN E PUNËS SË KUVENDIT KOMUNAL TË VITISË PËR VITIN 2021

Projekt Plani i Punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2021 do të jetë në shqyrtim publik *deri me datën: 07.09.2020.*

Duke u bazuar në gjendjen e krijuar nga virusi pandemik COVID-19 dhe të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës: 28.07.2020 me numër 01/17, konkretisht të pikave 6 dhe 7 nuk do të mbahet diskutimi publik, por të gjitha vërejtjet, sugjerimet apo komentet mund të dërgohen në formë elektronike të: fatlum.demiri@rks-gov.net deri me datë: 03.09.2020.

Me qëllim që qytetarët të njihen rreth këtij projekti, Komuna e Vitisë, konkretisht Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, ka publikuar këtë propozim dokument në ueb faqen zyrtare të Komunës së Vitisë, kk.rks-gov.net/viti në rubrikën “Dokumentet në Shqyrtim Publik”.

I mirëpresim komentet tuaj...

Zyra për Informim Publik dhe Marrëdhënie me Publikun

Komuna Viti